



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	4.12.2024
Nr.	3431 prot.

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. Projektvendim "Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025"
2. Projektvendim "Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025"
3. Projektvendim "Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacioneve shoqëruese.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Hirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

MBI

RREGULLAT PËR NUMËRIMIN DHE VLERËSIMIN E VOTAVE NGA JASHTË,
DOKUMENTACIONIN PËRKATËS, SI DHE TABELIMIN E REZULTATIT TË
VOTIMIT NGA JASHTË

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25/1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

KREU I

PARIMET

1. Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë respekton parimet e ligjshmërisë, paanërisë, transparencës dhe sigurisë për votën.
2. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës.

KREU II

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Data: dd mmvvvv Nr: 000-000
Ora: hh:mm



Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit.

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administron dhe numëron çdo fletë votimi që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në orën e mbylljes së votimit brenda vendit sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.
2. Çdo fletë votimi që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë pas orarit të mbylljes së votimit brenda vendit pranohet nga KQZ dhe administrohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Orari i hyrjes në Republikën e Shqipërisë verifikohet nëpërmjet vulës së hyrjes në zarfin e operatorit të shërbimit postar.
3. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë numërohen dhe vlerësohen në një ambient të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
4. Procesi i numërimit dhe i vlerësimit të votave nga jashtë, si dhe i tabulimit të rezultatit zgjedhor përkatës kryehet nga administrata e KQZ-së.
5. Numërimi, vlerësimi i votave nga jashtë, si dhe tabulimi i rezultatit kryehet veçmas për çdo zonë zgjedhore.
6. Procesi i numërimit fillon në të njëjtin moment që fillon numërimi i kutisë së parë me fletë votimi të zonës zgjedhore përkatëse, në votimin brenda vendit.
7. Subjektet zgjedhore, organizatat e shoqërisë civile dhe media kanë të drejtë të monitorojnë dhe vëzhgojnë procesin e numërimit dhe të vlerësimit të votës nga jashtë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor, këtë vendim si dhe me aktet e tjera nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

KREU III

PËRGATITJA PËR NUMËRIMIN DHE VLERËSIMIN E VOTAVE

III.1. Vendi i numërimit të votave

1. Vendi i numërimit të votave nga jashtë, nga këtu e vijim në këtë akt referuar si VNVJ caktohet me vendim të KQZ, jo më vonë se 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
2. Jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve Prefekti i Qarkut Tiranë vendos në dispozicion të KQZ, listën e objekteve sipas kërkesave të pikës 1 dhe 2 të nenit 93, si dhe të nenit 94 të Kodit Zgjedhor.
3. KQZ organizon VNVJ në përputhje me parashikimet e nenit 94 të Kodit Zgjedhor.
4. Në VNVJ lejohet të jenë të pranishëm vetëm:
 - a) Personeli/stafi i i KQZ;
 - b) Përfaqësuesit e akredituar të medias;
 - c) Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore;
 - d) Vëzhguesit e tjerë të akredituar;
 - e) Kandidatët;



5. Të gjithë personat e pranishëm në VNV, duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre.
6. Në VNVJ instalohen sisteme të monitorimit me kamera të ambientit të VNVJ, si dhe procesit të numërimit dhe të vlerësimit të votave, të njëjta me ato që vendosen në VNV në votimin brenda vendit.

III.2. Personeli përgjegjës për numërimin dhe vlerësimin e votave

1. Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë kryhet nga Komisioni i Numerimit dhe Vlerësimit të Votës nga Jashtë, nga këtu e vijim në këtë referuar si KNVJ, si dhe Grupe të Numërimit, të Votave nga Jashtë, nga këtu e vijim në këtë akt referuar si GNVJ.
2. KNVVJ përbëhet nga tre anëtarë të caktuar nga KQZ, jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
3. Anëtarët e KNVJ duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret sikurse ato të emërimit të anëtarit të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), përjashto kushtin e vendbanimit në zonën zgjedhore përkatëse. Anëtari KNVVJ shkarkohet për të njëjtat shkaqe që shkarkohet anëtari i KZAZ.
4. GNVJ përbëhet nga dy anëtarë të caktuar nga KQZ. Një nga anëtarët e GNVJ caktohet me deyrën e sekretarit. Vendimi për caktimin e anëtarëve të GNVJ merret jo më vonë se 10 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
5. Anëtarët e GNVJ duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret sikurse ato të emërimit të anëtarit të Grupit të Numërimit të Votave për votimin brenda vendit, përjashto kushtin e vendbanimit në zonën zgjedhore përkatëse. Anëtari GNVJ shkarkohet për të njëjtat shkaqe që shkarkohet edhe anëtari i GNV.
6. GNVJ caktohet veçmas për çdo zonë zgjedhore. Në zona zgjedhore ku numri i votuesve nga jashtë është më i madh se 5000, caktohen jo më pak se dy grupe numërimi, të cilat i kryejnë detyrat sipas këtij akti, njëri pas tjetrit, jo në të njëjtën kohë. Radha caktohet nga KQZ.
7. Partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës parlamentare kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues pranë tavolinës së çdo GNVJ. Këta vëzhgues kanë të drejtë vetëm të monitorojnë dhe vëzhgojnë procesin e numërimit dhe të vlerësimit të votave, si dhe të shënojnë komentet e tyre në *Procesverbalin e GNVJ për vlerësimin e dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë* përkatëse.
8. Anëtarët e GNVJ të caktuar në turnin e parë duhet të paraqiten në VNVJ, në tavolinën përkatëse të numërimit, jo më vonë se ora 21:00 e ditës së votimit.
9. Përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ kanë të drejtë të përjashtojnë nga qenia anëtarë i KNVVJ, ose i GNVJ çdo person të caktuar në atë detyrë në rast se kanë dyshime për profesionalizmin dhe paanësinë e tij. Këtë të drejtë ato e ushtrojnë vetëm një herë.



III.3. Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor të votimit nga jashtë në ambientet e VNVJ

1. Dokumentacioni zgjedhor i votimit nga jashtë i administruar sipas përcaktimeve të vendimit të Rregullatorit nr. 13 datë 12.11.2024 “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë” dërgohet/trasportohen në ambientet e VNVJ jo më vonë se ora 21.00 e ditës së votimit.
2. Për dorëzimin në VNVJ të Kutive të Votimit nga Jashtë, Kutive të Posaçme të Votimit nga Jashtë, Kutive Rezervë të Votimit nga Jashtë dhe Kutive të Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë, nga këti e vijim në akt referuar të gjitha si Kutitë, mbahet një *Procesverbal i Dorëzimit të Kutive të Dokumentacionit Zgjedhor nga Jashtë* midis të paktën një anëtarit të KQZ dhe personelit të KQZ që është ngarkuar me dorëzimin e kutive përkatëse. Kopje të këtij procesverbali marrin KQZ, si dhe vëzhguesit e partive parlamentare.
3. Përpara dorëzimit të Kutive nga KQZ tek KQZ, KQZ duhet të bëjë indeksimin e cdo kutie me numra natyror të njëpasnjëshëm duke filluar nga numri një vecmas për cdo lloj/kategori kutie.. Indeksi fillon në radhë sipas qarqeve sikurse janë numëruar qendrat e votimit të votimit brenda vendit. *Numri i indeksit vendoset në njërin prej faqeve anësore të çdo Kutie.*
4. Nëse gjatë marrjes në dorëzim të kutive rezulton se kodet e vulave të sigurisë nuk përputhen me ato të shënuara gjatë mbylljes së tyre, atëherë kutia përkatëse vlerësohet si “Kuti e Parregullt” dhe mbi të vendoset shënimi “Kuti e Parregullt”.
5. Kutia e Parregullt nuk i jepet GNVJ për numërim, apo vlerësim të votave, por i nënshtrohet një hetimi administrativ sipas përcaktimeve të neneit 136 dhe 138 të Kodit Zgjedhor.
6. Transportimi i Kutive nga ambienti ku ato ruhen dhe administrohen sipas vendimit të Rregullatorit nr. 13 datë 12.11.2024 “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë” për tek VNVJ bëhet i shoqëruar nga Policia e Shtetit.

KREU IV

NUMËRIMI DHE VLERËSIMI I VOTAVE

IV.1. Procedura për fillimin e numërimit dhe vlerësimin e votës nga jashtë vendit

1. Sekretari i KZAZ ka detyrimin të njoftoj menjëherë KQZ në momentin kur fillon numërimi i kutisë së parë të votimit brenda vendit. Njoftimi bëhet nëpërmjet platformave elektronike të komunikimit në adresat e përcaktuara nga KQZ.
2. Kur KQZ, në bazë të njoftimit të marrë nga KZAZ, apo KZAZ-të e zonës zgjedhore përkatëse konstaton se ka filluar numërimi i kutisë së parë të votimit brenda vendit për atë zonë zgjedhore, fillon menjëherë numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë për atë zonë.
3. Procesi i numërit dhe vlerësimit të dokumentacionit zgjedhor të administruar në llojet përkatëse të kutive fillon nga kutia e indeksuar me numrin 1.



IV.2. Procedura për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor të administruar në Kutinë e Votimit nga Jashtë.

1. Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit Kutinë e Votimit nga Jashtë dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato të procesverbalit të mbylljes së kutisë dhe i shënon ato në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*. Nëse ka mospërputhje, atëherë GNVJ njofton menjëherë KNNVJ e cila merr vendim për përfshirjen ose jo në numërim të asaj kutie. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor.
2. Pasi hap Kutinë e Votimit nga Jashtë sekretari i GNVJ në prani të anëtarit tjetër si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti Zarfat e Jashtëm të cilët kanë të shënuar Kodin Unik dhe i numëron ata. Numri i tyre shënohet në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*.
3. GNVJ nxjerrë nga secili prej Zarfeve të Jashtëm, zarfin që përmban fletën e votimit dhe shënon në *Procesverbalin e GNVJ për vlerësimin e dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë* numrin e zarfeve me fletë votimi të gjendura brenda Zarfeve të Jashtëm.
4. Nëse pas hapjes së Zarfit të Jashtëm konstatohet se mungon zarfi ku futet fleta e votimit, apo fleta e votimit gjendet jashtë këtij zarfi, apo në Zarfin e Jashtëm mungon Kodi Unik, atëherë GNVJ e shënon gjetjen në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*. Në këtë rast vota është e pavlefshme. Dokumentacioni zgjedhor i këtij i rasti administrohet në një zarf të veçantë.
5. Përfunduar rastet e parashikuara në pikën 5 të këtij kreu, Zarfet brenda të cilëve janë fletët e votimit, pasi janë nxjerrë nga Zarfet e Jashtëm, përpara se të numërohen dhe të vlerësohen, vendosen në një kuti plastike transparente dhe më pas përzihen po brenda kësaj kutie. Kutia pozicionohet në mënyrë të tillë që të mund të shikohet nga vëzhguesit.
6. Procesi i numërit dhe vlerësimit të votave kryhet fillimisht për subjektet zgjedhore, parti politike ose koalicionin i partive dhe më pas për kandidaët e preferuar.
7. Sekretari i GNVJ nxjerr me radhë nga secili zarf që mban fletën e votimit këtë të fundit dhe lexon me zë emrin e subjektit zgjedhor/parti politike/koalicion për të cilin është bërë shënimi përkatës në këtë fletë votimit. Njëkohësisht fleta e votimit shfaqet në një monitor për tu parë nga personat e tjerë të pranishëm në VNVJ. Vlerësimi i fletës së votimit bëhet sipas parashikimeve të Kreut V.1 të këtij akti.
8. Nëse në zarfin e fletës së votimit mungon fleta e votimit, atëherë rasti shënohet në *Procesverbalin e GNVJ për vlerësimin e dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*.



9. Nëse ndonjë prej anëtarëve të GNVJ ka kontestime në lidhje me vlerësimin e fletës së votimit, ky kontestim shënohet në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*. Në pjesën mbrapa të fletës së votimit, nga faqja që nuk janë emrat e subjekteve zgjedhorë, sekretari shënon fjalën “E kontestuar”.

10. Pasi përfundon numërimi dhe vlerësimi i fletëve të votimit sipas pikës 7 të këtij Kreu, Sekretari i GNVJ plotëson *Procesverbalin e GNVJ për vlerësimin e dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë* duke shënuar numrin e votave të vlefshme, numrin e votave të pavlefshme, numrin e votave për cdo subjekt zgjedhor, si dhe numrin e votave të kontestuara.

11. Fletët e votimit të numëruara dhe të vlerësuara nënshkruhen nga anëtarët e GNVJ në faqen që nuk janë emrat e subjekteve zgjedhorë. (*Variant: Ju vendoset një vulë*)

12. Pasi GNVJ ka shënuar në *Procesverbalin e GNVJ për vlerësimin e dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë* rezultatin e votimit për subjektet zgjedhore, parti politike dhe koalicionet partive, fillon numërimin e dhe vlerësimin e votave preferenciale për kandidatët për deputet. Numri i votave për cdo kandidat shënohet gjithashtu në *Procesverbalin e GNVJ për vlerësimin e dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*.

13. Fletët e votimit për cdo subjekt zgjedhor, apo kandidatë për deputet që ka marrë votë preferenciale vendosen në zarfa të veçantë.

14. Në përfundim të procesit të vlerësimin dhe të numërimit të fletëve të votimit sipas këtij kreu, GNVJ i fut ato në Kutinë e Votimit nga Jashtë. Në këtë kuti vendosen edhe Zarfat e Jashtëm. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*.

15. *Procesverbali i GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë* pasi nënshkruhet nga anëtarët e GNVJ dhe një kopje e tij dorëzohet tek KNVVJ.

IV.3. Procedura për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhur të administruar në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë

1. Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit *Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë* dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato të procesverbalit të mbylljes së kutisë dhe i shënon ato në *Procesverbali i GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë*. Nëse ka mospërputhje, atëherë GNVJ njofton menjëherë KNVVJ e cila merr vendim për përfshirjen ose jo në numërim të asaj kutie. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor.



2. Pasi hap *Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë* sekretari i GNVJ në prani të anëtarëve të tjerë, si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti dokumentacionin zgjedhor që përmban kjo kuti.
3. Nëse gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni gjenden Zarfë të Jashtëm të cilët përmbajnë Kodin Unik të Zgjedhësit dhe vula në zarfën e postës daton jo më vonë se ora 19:00 e ditës së votimit, atëhere GNVJ e vlerëson këtë dokumentacion sipas parashikimeve të Kreut IV. 2 të këtij akti duke bërë plotësimet përkatëse në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë*.
16. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor sipas këtij kreu GNVJ e rifut këtë dokumentacion në *Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë*. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë*.
17. *Procesverbali i GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë* pasi nënshkruhet nga anëtarët e GNVJ një kopje e tij dorëzohet tek KNVVJ.

IV.4. Procedura për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhur gjendur në *Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë*

1. Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit *Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë* dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato procesverbalit të mbylljes së kutisë dhe i shënon ato në *Procesverbali i GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë*. Nëse ka mospërputhje, atëhere GNVJ njofton menjëherë KNVVJ e cila merr vendim për përfshirjen ose jo në numërim të asaj kutie. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor.
2. Pasi hap *Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë* sekretari i GNVJ në prani të anëtarëve të tjerë, si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti dokumentacionin zgjedhor që përmban kjo kuti.
3. Nëse gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni GNVJ konstaton se vula në zarfën e operatorit të shërbimit postar daton jo më vonë se ora 19:00 e datës së zgjedhjeve, atëhere GNVJ e vlerëson këtë dokumentacion sipas parashikimeve të Kreut IV. 2 të këtij akti duke bërë plotësimet përkatëse në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë*.
4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor GNVJ e rifut këtë dokumentacion në *Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë*. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë*.
5. *Procesverbali i GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë* pasi nënshkruhet nga anëtarët e GNVJ një kopje e tij dorëzohet tek KNVVJ.

Data: dd mmvvvv Nr: 000-000
Ora: hh:mm



Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit.

IV.5 Procedura për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhur gjendur në *Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë*.

1. Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit *Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë* dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato procesverbalit të mbylljes së kutisë dhe i shënon ato në *Procesverballin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë*. Nëse ka mospërputhje, atëherë GNVJ njofton menjëherë KNVVJ e cila merr vendim për përfshirjen ose jo në numërim të asaj kutie. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor.
2. Pasi hap *Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë* sekretari i GNVJ në prani të anëtarëve të tjerë, si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti dokumentacionin zgjedhor që përmban kjo kuti.
3. Nëse gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni gjenden Zarfat të Jashtëm të cilët përmbajnë Kodin Unik të Zgjedhësit dhe vula në zarfin e operatorit të shërbimit postar daton jo më vonë se ora 19:00 e datës së zgjedhjeve, atëherë GNVJ e vlerëson këtë dokumentacion sipas parashikimeve të Kreut IV. 2 të këtij akti duke bërë plotësimet përkatëse në *Procesverballin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë*.
4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor GNVJ e rifut këtë dokumentacion në *Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë*. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në *Procesverballin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë*.
5. *Procesverballi i GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë* nënshkruhet nga anëtarët e GNVJ dhe një kopje e tij dorëzohet tek KNVVJ.

KREU V

LLOJET E VLERËSIMIT TË VOTAVE DHE TABELIMI I REZULTATIT

V.1. Llojet e vlerësimit të votave

1. Fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose në vota të pavlefshme.
2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor.
3. Krahas sa parashikohet tjetër në këtë akt vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:



- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;
- b) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
- c) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
- d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- e) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- f) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;
- g) nuk është e qartë se për kë është votuar;
- h) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

V.2. Tabelimi i rezultatit

1. Të dhënat mbi numrin e votave të subjekteve zgjedhorë dhe të kandidatëve të pasqyruara në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Votimit nga Jashtë*, në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë*, në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë* dhe në *Procesverbalin e GNVJ për Vlerësimin e Dokumentacionit në Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë* për çdo zonë zgjedhore përfshihet nga KNVVJ në Tabelën e Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës zgjedhore përkatëse. Kjo tabelë nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KNVVJ dhe më pas i dorëzohet KQZ.
2. KQZ përfshin të dhënat e Tabelës së Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës zgjedhore në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore përkatëse.

KREU VI

MONITORIMI DHE VËZHGIMI I PROCESIT

1. Çdo subjekt zgjedhor ka të drejtën e caktimit të një vëzhguesi për çdo tavolinë numërimi. Këtë të drejtë e ka edhe cdo organizatë vendase, apo e huaj e cila ka marrë akreditimin për vëzhgimin e zgjedhjeve nga KQZ.
2. Vëzhguesit kanë të drejtë të marrin kopje të Tabelës së Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore.


KREU V II

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet administrata e KQZ dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, me zbatimin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Votimit nga Jashtë

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

MBI

RREGULLAT PËR NUMËRIMIN DHE VLERËSIMIN E VOTAVE NGA JASHTË,
DOKUMENTACIONIN PËRKATËS, SI DHE TABULIMIN E REZULTATIT TË
VOTIMIT NGA JASHTË

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit.

Neni 25/1, pika 1 i Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur pas orarit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor për mbylljen e votimit në qendrat e votimit, me përjashtim të zarfeve me fletë votimi të cilat kanë vulën e hyrjes ose çdo shënim tjetër për këtë gjë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në orën e mbylljes së votimit brenda vendit, sipas këtij Kodi.

Neni 25/1, pika 4 i Kodit Zgjedhor parashikon se fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë vendit dhe të administruara numërohen në ambientet e KQZ-së. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë vendit në momentin e mbërritjes në KQZ regjistrohen në një regjistër të posaçëm dhe ndahen sipas zonës zgjedhore të vendbanimit më të fundit të zgjedhësit para largimit nga Shqipëria. Procesi i numërimit të tyre fillon në të njëjtën moment që fillon numërimi i kutisë së parë me fletë votimi të zonës zgjedhore përkatëse, si dhe vlerësimi i tyre kryhet nga administrata e KQZ-së dhe tabulohen në tabelën e rezultateve të zonës zgjedhore përkatëse.

Komisioni Rregullator, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij si dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimit, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe dokumentacionit në lidhje me administrimin, vëzhgimin e procesit

të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës nga jashtë vendit dhe tabulimin e rezultatit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025.

Projektakti rendit parime të përgjithshme, të cilat janë shtyllat ku do të mbështetet procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë dhe përfshirja e tyre në rezultatin e zgjedhjeve.

Në kreun I të projektvendimit parashikohen parimet si më poshtë vijon:

- 1. Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë respekton parimet e ligjshmërisë, paanërisë, transparencës dhe sigurisë për votën.*
- 2. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e votës të shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet në mënyrë që të përmirësohen proceset dhe të adresohen situata të paparashikuara për të garantuar realizimin e votës.*

Në kreun II parashikohen rregulla të përgjithshme të përcaktuara në ligj sa i takon procesit të administrimit, numërimit dhe vlerësimit të votave nga jashtë të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administron dhe numëron çdo fletë votimi që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri nëse ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë pas orarit të mbylljes së votimit brenda vendit pranohet nga KQZ dhe administrohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Orari i hyrjes në Republikën e Shqipërisë verifikohet nëpërmjet vulës së hyrjes në zarfin e operatorëve të shërbimit posta.

Numërimi dhe vlerësimi i fletëve të votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të RSH do të kryhet nëKQZ një ambient të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Procesi i numërimit, vlerësimit të votave nga jashtë dhe tabulimit të rezultatit zgjedhor kryhet nga adminstrata e KQZ – së.

Procesi i numërimit fillon në të njëjtin moment që fillon numërimi i kutisë së parë me fletë votimi të zonës zgjedhore përkatëse. Numërimi, vlerësimi i votave nga jashtë dhe tabulimi i rezultatit kryhet veçmas për çdo zonë zgjedhore.

Në këtë kre parashikohet e drejta e subjekteve zgjedhore, medias, organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar dhe vëzhguar procesin e numërimit dhe vlerësimit të votës nga jashtë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor, këtë vendim, si dhe me aktet e tjera nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në kreun III parashikohen rregulla të posaçme që lidhen me Përgatitjen për Numërimin dhe Vlerësimin e Votave nga Jashtë, personelit përgjegjës për numërimin dhe vlerësimin e votave, dhe në lidhje me dërgimin e dokumentacionit zgjedhor të votimit nga jashtë në ambientet e VNVJ.

Në zbatim të nenit 93, pikës 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor me titull “Vendndodhja e qendrave të votimit, Selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave”, parashikohet detyrimi i Prefektit të Tiranës për t’i paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

Vendi i Numërimit të Votave nga Jashtë, nga këtu e në vijim referuar si “VNVJ”. KQZ organizon VNVJ në përputhje me parashikimet e nenit 94 të KZ me titull “Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave”. Në VNVJ lejohet të jenë të pranishëm vetëm:

- a) Personeli/stafi i i KQZ ;
- b) Përfaqësuesit e akredituar të medias;
- c) Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore;
- d) Vëzhguesit e tjerë të akredituar;
- e) Kandidatët; të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre, si dhe në VNVJ instalohen sisteme të monitorimit me kamera të ambientit në VNVJ, si dhe procesit të numërimit dhe të vlerësimit të votave, të njëjta me ato që vendosen në VNV në votimin brenda vendit.

Në lidhje me personelin përgjegjës për numërimin dhe vlerësimin e votave, projektakti parashikon rregulla në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave, tabulimin e rezultatit të votimit nga jashtë, si dhe përbërjen dhe funksionimin e grupeve të numërimit.

Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë kryhet nga Komisioni i Numërimit dhe Vlerësimit të Votës nga Jashtë, referuar në vijim si KNVJ, si dhe Grupe të Numërimit të Votave nga Jashtë, referuar si GNVJ.

KNVJ përbëhet nga tre anëtarë të caktuar nga KËZ, jo më vonë se 20 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Anëtarët e këtij Komisioni duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret sikurse ato për emërimin e anëtarit të KZAZ/ Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor, me përjashtim të kushtit të vendbanimit në zonën zgjedhore përkatëse. Shkarkimi i anëtarit të KNVJ do të bëhet për të njëjtat shkaqe që vlejné për shkarkimin e anëtarit të KZAZ.

GNVJ përbëhet nga dy anëtarë të caktuar nga KQZ. Një nga anëtarët e GNVJ caktohet me deyrën e sekretarit. Vendimi për caktimin e anëtarëve të GNVJ merret jo më vonë se 10 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Anëtarët e GNVJ duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret sikurse ato të emërimit të anëtarit të Grupit të Numërimit të Votave për votimin brenda vendit, me përjashtim të kushtit të vendbanimit në zonën zgjedhore përkatëse. Shkarkimi i anëtarit të GNVJ do të bëhet për të njëjtat shkaqe që vlejné për shkarkimin e anëtarit të GNV. Për çdo zonë zgjedhore caktohet veçnas GNVJ. Në zona zgjedhor ku numri i votuesve nga jashtë është më i madh se 5000, caktohen jo më pak se dy grupe numërimi, që i kryejné detyrat njëri pas tjetrit, jo në të njëjtën kohë, sipas rradhës së caktuar nga KQZ.

Partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe partia më e madhe e opozitës parlamentare kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues pranë tavolinës së çdo GNVJ. Anëtarët vëzhgues të GNVJ kanë të drejtë vetëm të monitorojné dhe vëzhgojnë procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave, si dhe të shënojnë komentet e tyre në Tabelën e Rezultatit të GNVJ përkatëse. Anëtarët e GNVJ të caktuar në turnin e parë duhet të paraqiten në VNVJ, në tavolinën përkatëse të numërimit, jo më vonë se ora 21:00 e ditës së votimit. Përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ kanë të drejtë të përjashtojné nga qenia anëtarë i KNVVJ, ose i GNVJ çdo person të caktuar në atë detyrë në rast se kanë dyshime për profesionalizmin dhe paanësinë e tij. Këtë të drejtë ato e ushtrojnë vetëm një herë.

Në lidhje me dërgimin e dokumentacionit zgjedhor të votimit nga jashtë në ambientet e VNVJ-së, në projekakt parashikohet se dokumentacioni zgjedhor i votimit nga jashtë i administruar sipas përcaktimeve të vendimit të Rregullatorit nr. 13 datë 12.11.2024 “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë” dërgohet/transportohen në ambientet e VNVJ jo më vonë se ora 21.00 e ditës së votimit.

Për dorëzimin në VNVJ të Kutive të Votimit nga Jashtë, Kutive të Posaçme të Votimit nga Jashtë, Kutive Rezervë të Votimit nga Jashtë dhe Kutive të Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë, referuar në vijim të gjitha si Kutitë, mbahet një **Procesverbal i Dorëzimit të Kutive të Dokumentacionit Zgjedhor nga Jashtë** midis të paktën një anëtari të KQZ dhe personelit të KQZ që është ngarkuar me dorëzimin e kutive përkatëse. Kopje të këtij procesverbali marrin KQZ, si dhe vëzhguesit e partive parlamentare.

Përpara dorëzimit të Kutive nga KQZ tek KQZ, KQZ duhet të bëjë indeksimin e çdo kutie me numra natyror të njëpasnjëshëm duke filluar nga numri një vecmas për çdo lloj/kategori kutie.

Indeksi fillon në radhë sipas qarqeve sikurse janë numërtuar qendrat e votimit të votimit brenda vendit. **Numri i indeksit vendoset** në njërin prej faqeve anësore të çdo Kutie.

Nëse gjatë marrjes në dorëzim të kutive rezultojnë se kodet e vulave të sigurisë nuk përputhen me ato të shënuara gjatë mbylljes së tyre, atëherë kutia përkatëse vlerësohet si “Kuti e Parregullt” dhe mbi të **vendoset shënimi “Kuti e Parregullt”**, e cila nuk i jepet GNVJ për numërim, apo vlerësim të votave, por i nënshtrohet një hetimi administrativ sipas përcaktimeve të neneit 136 dhe 138 të Kodit Zgjedhor.

Transportimi i Kutive nga ambienti ku ato ruhen dhe administrohen sipas vendimit të Rregullatorit nr. 13 datë 12.11.2024 “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë” për tek VNVJ bëhet i shoqëruar nga Policia e Shtetit.

Në kreun IV të këtij projektvendimi, përcaktohen rregulla lidhur me numërimin dhe vlerësimin e votës nga jashtë vendit, procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor të administruar në Kutinë e Votimit nga Jashtë, procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor gjendur në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë, procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor gjendur në Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë, procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor gjendur në Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë.

Në lidhje me procedurën për fillimin e numërimit dhe vlerësimin të votës nga jashtë vendit, në projektakt parashikohet se kur KQZ, në bazë të njoftimit të marrë nga KZAZ, apo KZAZ-të e zonës zgjedhore përkatëse konstaton se ka filluar numërimi i kutisë së parë të votimit për atë zonë zgjedhore, fillon menjëherë numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë për atë zonë zgjedhore. Sekretari i KZAZ ka detyrimin të njoftojë menjëherë KQZ në momentin kur fillon numërimi i kutisë së parë të votimit brenda vendit. Njoftimi bëhet nëpërmjet platformave elektronike të komunikimit në adresat e përcaktuara nga KQZ. Procesi i numërimit dhe vlerësimin të dokumentacionit zgjedhor të administruar në llojet përkatëse të kutive fillon nga kutia e indeksuar me numrin 1.

Në lidhje me procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor të administruar në Kutinë e Votimit nga Jashtë, projektakti parashikon Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit Kutinë e Votimit nga Jashtë dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato të mbylljes së kutisë dhe i shënon ato në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ** përkatëse. Nëse ka mospërputhje, atëherë GNVJ njofton menjëherë KQZ dhe cila merr vendim për përfshirjen ose jo në numërim të asaj kutie. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor. Pasi hap Kutinë e Votimit nga Jashtë sekretari i GNVJ në prani të anëtarit tjetër si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti Zarfat e Jashtëm të cilët kanë të shënuar Kodin Unik dhe i numëron ata. Numri i tyre shënohet në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ**.

GNVJ nxjerrë nga secili prej Zarfeve të Jashtëm, zarfin që përmban fletën e votimit dhe shënon në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ** numrin e zarfeve me fletë votimi të gjendura brenda Zarfeve të Jashtëm.

Nëse pas hapjes së Zarfit të Jashtëm konstatohet se mungon zarfi ku futet fleta e votimit, apo fleta e votimit gjendet jashtë këtij zarfi, apo në Zarfin e Jashtëm mungon Kodi Unik, atëherë GNVJ e shënon gjetjen në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ**. Në këtë rast vota është e pavlefshme. Dokumentacioni zgjedhor i këtij i rasti administrohet në një zarf të veçantë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij kreu.

Zarfet brenda të cilëve janë fletët e votimit, pasi janë nxjerrë nga Zarfet e Jashtëm, përpara se të numërohen dhe të vlerësohen, vendosen në një kuti plastike transparente dhe më pas përzihen po brenda kësaj kutie. Kutia pozicionohet në mënyrë të tillë që të mund të shikohet nga vëzhguesit. Procesi i numërit dhe vlerësimit të votave kryhet fillimisht për subjektet zgjedhore, parti politike ose koalicionin i partive dhe më pas për kandidatët e preferuar.

Sekretari i GNVJ nxjerr me radhë nga secili zarf që mban fletën e votimit këtë të fundit dhe lexon me zë emrin e subjektit zgjedhor/parti politike/koalicion për të cilin është bërë shënimi përkatës në këtë fletë votimit. Njëkohësisht fleta e votimit shfaqet në një monitor për tu parë nga personat e tjerë të pranishëm në VNVJ. Vlerësimi i fletës së votimit bëhet sipas parashikimeve të Kreut III.8 të këtij akti. Nëse në zarfin e fletës së votimit mungon fleta e votimit, rasti shënohet në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ**.

Nëse ndonjë prej anëtarëve të GNVJ ka kontestime në lidhje me vlerësimin e fletës së votimit, ky kontestim shënohet në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ**. Në pjesën mbrapa të fletës së votimit, nga faqja që nuk janë emrat e subjekteve zgjedhorë, sekretari shënon fjalën “E kontestuar”.

Pasi përfundon numërimi dhe vlerësimi i fletëve të votimit sipas këtij projektakti, Sekretari i GNVJ plotëson **Tabelën e Rezultatit të GNVJ** duke shënuar numrin e votave të vlefshme, numrin e votave të pavlefshme, numrin e votave për çdo subjekt zgjedhor, si dhe numrin e votave të kontestuara.

Fletët e votimit të numëruara dhe të vlerësuara nënshkruhen nga anëtarët e GNVJ në faqen që nuk janë emrat e subjekteve zgjedhorë. (*Variant: Ju vendoset një vulë*). Pasi GNVJ ka shënuar në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ** rezultatin e votimit për subjektet zgjedhore, parti politike dhe koalicionet partive, fillon numërimin e dhe vlerësimin e votave preferenciale për kandidatët për deputet. Numri i votave për çdo kandidat shënohet gjithashtu në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ**. Fletët e votimit për çdo subjekt zgjedhor, apo kandidatë për deputet që ka marrë votë preferenciale vendosen në zarfa të veçantë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit dhe të numërimit të fletëve të votimit sipas këtij kreu, GNVJ i fut ato në Kutinë e Votimit nga Jashtëm këtë kuti vendosen edhe Zarfat e Jashtëm. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në **Tabelën e Rezultatit të GNVJ**.

Në lidhje me procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor gjendur në Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë, në projektakt parashikohet se sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit **Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë** dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato të mbylljes së kutisë dhe i shënon ato në Procesverbalin e Votimit nga Jashtë të Zonës zgjedhore përkatëse. Nëse ka mospërputhje, atëherë GNVJ heton për shkaqet e mospërputhjes dhe merr vendim për moshapjen e kësaj kutie. Kundër këtij vendimi të GNVJ bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor.

Pasi hap **Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë** sekretari i GNVJ në prani të anëtarëve të tjerë, si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti dokumentacionin zgjedhor që përmban kjo kuti.

Nëse gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni gjenden Zarfa të Jashtëm të cilët përmbajnë Kodin Unik të Zgjedhësit GNVJ e vlerëson këtë dokumentacion sipas parashikimeve të Kreut III.4 të këtij akti duke bërë korrigjimet përkatëse në Tabelën e Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore nëse është rasti. Në këtë rast vula në zarfin e postës duhet të datojë jo më vonë se ora 19:00 e ditës së votimit.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor GNVJ i rifut atë në ***Kutinë e Posaçme të Votimit nga Jashtë***. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në Procesverbalin të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore.

Në lidhje me procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhor gjendur në Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë, në projektakt parashikohet se Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit ***Kutinë Rezervë e Votimit nga Jashtë*** dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato të mbylles së kutisë dhe i shënon ato në Procesverbalin e Votimit nga Jashtë të Zonës zgjedhore përkatëse. Nëse ka mospërputhje, atëhere GNVJ heton për shkaqet e mospërputhjes dhe merr vendim për moshapjen e kësaj kutie. Kundër këtij vendimi të GNVJ bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në neni 124 të Kodit Zgjedhor.

Pasi hap ***Kutinë Rezervë të Votimit nga Jashtë*** sekretari i GNVJ në prani të anëtarëve të tjerë, si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti dokumentacionin zgjedhor që përmban kjo kuti.

Nëse gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni GNVJ konstaton se vula në zarfin e operatorit të shërbimit postar datoj jo më vonë se ora 19:00 e datës së zgjedhjeve e vlerëson këtë dokumentacion sipas parashikimeve të Kreut III.4 të këtij akti duke bërë korrigjimet përkatëse në Tabelën e Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore nëse është rasti.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor GNVJ i rifut atë në ***Kutinë e Rezervë të Votimit nga Jashtë***. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në Procesverbalin të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore.

Në lidhje me procedurën për numërimin dhe vlerësimin e dokumentacionit zgjedhur gjendur në Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtëm, në projektakt parashikohet se Sekretari i GNVJ vendos mbi tavolinën e numërimit ***Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë*** dhe lexon kodet e vulave të sigurisë me të cilat është mbyllur kjo kuti. Verifikohet nëse kodet e vulave të sigurisë janë të njëjta me ato të mbylles së kutisë dhe i shënon ato në Procesverbalin e Votimit nga Jashtë të Zonës zgjedhore përkatëse. Nëse ka mospërputhje, atëhere GNVJ heton për shkaqet e mospërputhjes dhe merr vendim për moshapjen e kësaj kutie. Kundër këtij vendimi të GNVJ bëhet ankim sipas procedurave të përcaktuara në nenin 124 të Kodit Zgjedhor.

Pasi hap ***Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë*** sekretari i GNVJ në prani të anëtarëve të tjerë, si dhe të vëzhguesve nxjerr nga kjo kuti dokumentacionin zgjedhor që përmban kjo kuti.

Nëse gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni gjenden Zarfa të Jashtëm të cilët përmbajnë Kodin Unik të Zgjedhësit GNVJ e vlerëson këtë dokumentacion sipas parashikimeve të Kreut III.4 të këtij akti duke bërë korrigjimet përkatëse në Tabelën e Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore nëse është rasti. Në këtë rast vula në zarfin e postës duhet të datojë jo më vonë se ora 19:00 e ditës së votimit.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor GNVJ i rifut atë në ***Kutinë e Posaçme Rezervë të Votimit nga Jashtë***. Kutia mbyllet me vula sigurie me kod. Të dhënat e kodeve të vulave të sigurisë shënohen në Procesverbalin të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore.

Në Kreun V të këtij projektvendimi parashikohen rregullat në lidhje me llojet e vlerësimit të votave dhe tabulimit të rezultatit zgjedhor.

Sa i përket llojet e vlerësimit të votave, në zbatim të nenit 117 të Kodit Zgjedhor përcaktohen llojet e votave, si dhe kriteret për vlerësimin e tyre. Referuar përcaktimit të këtij neni, fletët e votimit ndahen në vota të vlefshme ose në vota të pavlefshme. *Vota të vlefshme* janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor.

Krahas sa parashikohet tjetër në këtë akt vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;
- b) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
- c) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
- d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- e) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- f) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;
- g) nuk është e qartë se për kë është votuar;
- h) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

Në lidhje me tabulimin e rezultatit të votave nga jashtë, në projektakt parashikohet se numri i votave të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor, si dhe të dhëna të tjera të pasqyruara në Tabelën e Rezultatit të Votimit nga Jashtë përfshihen nga KQZ në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore përkatëse.

Në Kreun VI të këtij projektvendim përcaktohen rregulla lidhur me monitorimin dhe vëzhgimin e proceseve të rregulluara nga ky vendim, ku përcaktohet e drejta e çdo subjekti për të caktuar një vëzhgues për çdo taavolinë numërimi. Këtë të drejtë e ka edhe çdo organizatë vendase apo e huaj, e cila ka marrë akreditimin për vëzhgimin e zgjedhjeve nga KQZ.

Vëzhguesit kanë të drejtë të marrin kopje të Tabelës së Rezultatit të Votimit nga Jashtë të Zonës Zgjedhore.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, *“Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabulimin e rezultatit të votimit nga jashtë”*.

Në datën **12 Nëntor**, projektvendimi *“Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës dhe mënyrën e plotësimit të tij, si dhe tabulimin e rezultatit të votimit nga jashtë”*.

- ju është dërguar për konsultim publik nëpërmjet email-it:
 - Komisionit Rregullator;
 - Përfaqësuesve të partive politike;

- Përfaqësuesve të organizatave të diasporës, organizatave të shoqërisë civile vendase të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, veprimtaria e të cilave ka në fokus zgjedhjet;

duke i lënë në dispozicion një afat për dërgimin e komenteve/ sugjerimeve nga ana e tyre deri në datën **15 Nëntor, ora 16:00.**

- KSHZ ka zhvilluar me përfaqësues të organizatave të diasporës, organizatave të shoqërisë civile vendase të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, veprimtaria e të cilave ka në fokus zgjedhjet një takim konsultativ online **në datën 14 Nëntor, ora 17.00-18.30** (me orën e Tiranës) ku u morën dhe u reflektuan një sërë mendimesh si shpjeguar në sesionin më poshtë.

Bashkërendimi i projektvendimit me palët e interesuara

Kanë shprehur mendimet e tyre me shkrim në lidhje me këtë projektvendim KRIIK dhe Shqipëria Bëhet:

-KRIIK, me shkresën nr. 241/21 Prot., datë 15.11.2024 duke shprehur disa rekomandime lidhur me projektvendimin “Mbi rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e zgjedhjeve”. KRIIK sjell në vëmendje

Mungesën e qartësisë mbi autoritetin vendimmarrës në të gjithë procesin e numërimit të votave nga jashtë apo, akoma më problematike, veshja e GNVJ-ve me kompetenca vendimmarrëse. Sipas KRIIK, GNVJ nuk mund të ketë legjitimitetin e duhur lidhur me të tilla vendimmarrje që mund të afektojnë rezultatin zgjedhor. Në gjykimin e KRIIK, duhet të jetë vetëm një trupë që kryen detyra kleralike, të ngjashme me ato të GNV-ve dhe të kenë të njëjtat kompetenca. Sipas vlerësimit të KQZ-së, ky rekomandim nuk qëndron, pasi vendimmarrja me shumicë e GNVJ-ve ka qenë në fakt qëllimi jonë përsa kohë kemi parashikuar numër tek në përbërje.

Në lidhje me anëtarësinë e GNVJ-ve, KRIIK rekomandon që formulimi i projektaktit t’i qëndrojë besnik gjuhës së përdorur nga Kodi Zgjedhor në të gjitha pikat, duke bërë të qartë se është administrata e KQZ-së që do të kryejë numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë. Duhet të përcaktohet qartë se administratë e KQZ-së, në funksion të këtij procesi, do të konsiderohet trupa e përkohshme e administratës së institucionit, apo dhe mund të përfshihen si pjesë e kësaj administrate, në rast se do të jetë e nevojshme, punonjës të përhershëm të KQZ-së.

Gjithashtu KRIIK rekomandon se edhe kutitë e votimit nga jashtë do të duhet t’i nënshtrohen **Procesit të Auditimit Pas zgjedhor**, në lidhje me këtë KQZ duhet të parashikojë amendimet e nevojshmenë aktet nënligjore përkatëse së bashku me masat administrative që do të ndërmerren në rast shkeljeje. **Informacioni mbi procesin e auditimit post-zgjedhor dhe pasojat e dala prej tij, të bëhen pjesë e sesioneve informuese gjatë trajnimeve si dhe e kontratave që do të lidhen. Lidhur me këtë rekomandim të KRIIK, KQZ sqaron se administrata e KQZ-së dhe personeli shtesë për këtë proces, në kuptimin e marrëdhënieve të punës dhe angazhimit në KQZ janë e njëjta gjë. Personi i kontraktuar me kontrata disamujore në KQZ janë staf me kohë të plotë të cilët deklarohen në KQZ në organet tatimore e për të cilët paguhen kontribute për periudhën e caktuar të punësimit. Ata nënshkruajnë kontrata pune me detyra e përgjegjësi të qarta për çdo proces (ashtu sikundër në këtë rast për votimin nga jashtë). Përgjegjësia nga ana tjetër për anëtarët e GNVJ ashtu sikundër edhe për ata brenda vendit është administrative dhe penale në bazë të legjislacionit në fuqi.**

Në lidhje me transportin e materialeve zgjedhore dhe fletëve të votimit nga jashtë nga KQZ-ja në VNVJ, sipas të cilit QZ do të kontraktojë një ambient jashtë godine ku ushtron aktivitetin e vet, ky parashikim duhet të saktësojë tërë detajet e nevojshme qoftë për transportin nga KQZ-ja drejt sallës ku do të kryhet numërimi apo nga kompania postare direkt në këtë

ambient që në fillim të procesit, si edhe dërgimin e tyre më pas në ambientet ku materialet do të ruhen në vijim.

Thënë sa më sipër, KQZ-ja nevojitet gjithashtu të ketë në konsideratë faktin që procesi i votimit nga jashtë në tërësinë e tij duhet të përmbajë së paku të njëjtat hallka sikurse ai brenda vendit si dhe përmbajtjen e akteve të miratuara tanimë nga KQZ-ja.

Në vlerësimin e KQZ-së lidhur me këtë projektvendim, sipas shpjegimeve të dhëna në takimin online, administrimi i dokumentacionit zgjedhor deri ditën e zgjedhjeve dhe gjatë numërimit do të bëhet logjikshëm jashtë godinës kryesore të KQZ pasi ajo nuk disponon hapësirat e nevojshme për këtë qëllim duke qenë se ndërkohë në këtë godinë zhvillohen edhe aktivitetet e tjera të KQZ në funksion të zgjedhjeve brenda vendit.

Kushtet dhe kriteret për këtë vendodhje janë ato të parashikuara nga Kodi si për të gjithë VNV-të e tjera, konkretisht:

III.1 Vendi i numërimit të votave

- 1. Vendi i numërimit të votave nga jashtë, nga këtu e vijim në këtë akt referuar si VNVJ caktohet me vendim të KQZ, jo më vonë se 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve.**
- 2. Jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve Prefekti i Qarkut Tiranë vendos në dispozicion të KQZ, listën e objekteve sipas kërkesave të pikës 1 dhe 2 të nenit 93, si dhe të nenit 94 të Kodit Zgjedhor.**
- 3. KQZ organizon VNVJ në përputhje me parashikimet e nenit 94 të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë kushtet dhe garancitë që duhet të ketë vendi ku ruhen dhe administrohen votat deri në fillim të numërimit parashikohet në Vendimin 13/2024 të KRR, seksioni III.4 pika 2, si vijon:**

Operatori i shërbimit postar ka detyrimin që pritja, grumbullimi dhe ruajtja e dokumentacionit zgjedhor nga momenti i mbërritjes në Republikën e Shqipërisë deri në dërgimin e këtij dokumentacioni në KQZ duhet të bëhet në një ambient të posacëm i cili duhet të ketë shërbim të monitorimit me kamera. Regjistrimet e këtij monitorimi ruhen në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, por në cdo rast deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Me kërkesë, subjekteve zgjedhore u vihet në dispozicion një kopje e regjistrimeve të këtij monitorimi.

Në lidhje me “anëtarët vëzhgues” të GNVJ-ve, KRIIK rekomandon se është e nevojshme që në akt të përcaktohet procedura e propozimit, emërimit, si dhe e shkarkimit të tyre. Në vlerësimin e KQZ-së, parashikimi i bërë në pikën 7 të seksionit III.2 për numrin e vëzhguesve në tryezën e numërimit është bërë për të krijuar lehtësi logjistike dhe për të mos krijuar konfuzion në tavolinën e numërimit. Aktualisht sipas këtij projektvendimi në çdo tavolinë do të jenë: 3 anëtarët e GNVJ dhe 2 vëzhgues. Sa më shumë rritet ky numër, aq më e vështirë dhe konfuzë mund të bëhet puna për numëruesit të cilët duhet të kenë qetësinë dhe mundësinë të kryejnë detyrën. Deri më tani, nuk ka pasur koment apo propozim/prendim të tillë nga partitë të cilat e kanë këtë projektvendim për konsultim.

Në lidhje me të drejtën e kontestimit të vlerësimit të fletëve të votimit, KRIIK konstaton se është e paqartë nëse anëtarët vëzhgues mund të kontestojnë ose jo vlerësimin e fletëve të votimit, njësoj si anëtarët e tjerë të GNVJ-së. Duke qenë se kjo kategori vëzhguesish anëtarë nuk është e përcaktuar në Kodin Zgjedhor, kjo e drejtë, apo mungesa e saj, nuk mund të eduktohen as nga as nga kuadri ligjor parësor, pra është e nevojshme që të përcaktohet qartë në këtë akt e drejta ose jo e anëtarëve vëzhgues për të kontestuar vlerësimin e fletëve të votimit.

Duke qenë se një e drejtë e njohur nga Kodi Zgjedhor nuk mund të anashkalohej me një akt të

KQZ-së, logjikshëm e drejta për të kontestuar një fletë votimi do të duhet t'u njihet edhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Në mënyrë që të evitohen ngërçe apo interpretime gjatë numërimit, **KRIIK gjykon se duhet të përcaktohet qartë në akt dhënia e së drejtës vëzhguesve të subjekteve zgjedhore për të kontestuar vlerësimin e një flete votimi, si dhe parashikimi i procedurave në vijim.**

Gjithashtu, duke patur në konsideratë se në rastet e votave të kontestuara në procesin e numërimit brenda vendit është KZAZ-ja që vendos nëse janë të vlefshme apo të pavlefshme, në këtë rast është e nevojshme të përcaktohet se trupa që duhet të vendosë nëse vota e kontestuar nga anëtarët apo vëzhguesit është e vlefshme ose jo, të jetë trupa nga administrata që mbikëqyr dhe drejton punën e GNVJ-ve. Në vlerësimin e KQZ-së është e ezauruar me faktin që në Kod edhe vëzhguesit në VNV kontestojnë e në këtë rast subjektet kanë vëzhgues në VNVJ, gjithsesi nuk na kushton për ta reflektuar -Komenti u pranua dhe u reflektua në projektvendim në piken III.4.9.

Në lidhje me lidhje me modalitetin e njoftimit për nisjen e numërimit të votave brenda vendit, KRIIK rekomandon se projektakti duhet të përcaktojë në mënyrë shteruese metodat që mund të përdoren për përcjelljen e njoftimit, si dhe personin përgjegjës për marrjen dhe përcjelljen e këtij njoftimi tek GNVJ-ja përkatëse. Dhe nëse do të gjykohej e arsyeshme të vendoset një trupë vendimmarrëse dhe menaxhuese e këtij procesi (KZAZJ-ja), atëherë njoftimi mund të kryhet direkt aty duke përcaktuar kontaktin e kryetarit apo sekretarit të kësaj trupe. Nëse propozimi i bërë nuk do të merret në konsideratë, atëherë duhet të parashikohet në akt pozicioni në administratën e KQZ-së i personit që do të jetë përgjegjës për këtë proces, ose mënyrën e përcaktimit të tij, p.sh me urdhër të Komisionerit. -Komenti u pranua dhe u reflektua në projektvendim në seksionin III.3 pika 1 sikundër vijon: “Sekretari i KZAZ ka detyrimin të njoftojë menjëherë KQZ në momentin kur fillon numërimi i kutisë së parë të votimit brenda vendit. Njoftimi bëhet nëpërmjet postës elektronike, ose nëpërmjet mesazhit në aplikacionin KQZ, apo aplikacione të tjera.”

-Detyra konkrete e cila do t'i ngarkohet njërit prej anëtarëve ose sekretarit të KZAZ-së specifikohet në detyrat/përgjegjësitë dhe manualët e punës së tyre dhe nuk gjen vend në një akt normues.

***Shqipëria Bëhet** në datën 25. 11. 2024 ka parashtruar rekomandimet e saj mbi vëzhguesit në Numërimin e Vlerësimit të Votës nga Jashtë dhe shprehet se në projekakt parashikohet shprehimisht e drejta e çdo subjekti zgjedhor për të pasur një vëzhgues për çdo tavolinë numërimi. Përsa më lart, propozojnë rishikimin/ saktësimin në mënyrë që të mos i mohohet e drejta e vëzhguesve partive jo parlamentare ose atyre me numër të vogël përfaqësuesish në Parlament.*

Jona JOSIFI - Drejtorja e Votimit nga Jashtë

Pavlina DOÇAJ – Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
CAKTIMIN E NUMRIT TË MANDATEVE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË VITIT 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME
LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr.10019, date 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend.

Bazuar në nenin 74, pika 1, të Kodit Zgjedhor, zona zgjedhore për Kuvendin përputhet me territorin e qarkut që shërben si zonë zgjedhore.

Në nenin 75 të Kodit Zgjedhor parashikohen kriteret dhe procedura për caktimin e numrit të mandateve. Çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish. Numri total i shtetasve, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, pjesëtohet me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, duke përcaktuar numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati të Kuvendit. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet duke pjesëtuar numrin e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore, me numrin mesatar, të përfutur sipas pikës 2 të këtij neni. Çdo zone zgjedhore i caktohet fillimisht një numër mandatesh i barabartë me numrin e plotë të përfutur nga pjesëtimi, sipas pikës 3 të këtij neni. Në rast se në përfundim të veprimt të kryer, sipas pikës 4 të këtij neni, një apo më shumë mandate mbeten pa u shpërndarë, ato u shpërndahen zonave mbi bazën e presjes dhjetore më të madhe të përfutur nga pjesëtimi, sipas pikës 3 të këtij neni. Shpërndarja e mandateve të mbetura kryhet në rend zbritës, duke filluar nga zona me presjen dhjetore më të madhe. Në rast se edhe pas zbatimit të pikës 5 të këtij neni presja dhjetore e dy apo më shumë zonave është e njëjtë, mandati i fundit i caktohet asaj zone që, pas përllogaritjes sipas pikës 3 të këtij neni, ka numrin më të madh të mbetur të shtetasve që nuk kanë prodhuar mandat të plotë.

Neni 76, pika 1, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se si rregull 4 muaj para datës së fillimit të periudhës zgjedhore, që i paraprin fundit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me kërkesë të KQZ-së, dërgon numrin e përgjithshëm të shtetasve si dhe numrin e shtetasve për çdo qark, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile”. Ndërsa pika 2 i të njëjtit nen përcakton se përllogaritja dhe miratimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore kryhet brenda 15 ditëve nga marrja e të dhënave sipas pikës 1 të këtij neni.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKVENDIMIT

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektvendimi “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

Referuar nenit 76, pika 1, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3253 Prot., datë 15.11.2024, i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për numrin e përgjithshëm të shtetasve dhe numrin e shtetasve për çdo qark, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nëpërmjet emailit të datës 04.11.2024, i ka dërguar KQZ-së të dhënat e kërkuara, duke përcaktuar se numri i shtetasve është i datës 1 dhjetor 2024.

Nisur nga sa më sipër, të dhënat e marra nga Ministria e Brendshme respektojnë plotësisht kërkesat dhe janë marrë brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Këto të dhëna i lejojnë KQZ-së të zbatojë detyrimet ligjore që përcakton “Pjesa V” e Kodit Zgjedhor.

Referuar kriterëve dhe procedurës për caktimin e numrit të mandateve të përcaktuara në nenin 75, të Kodit Zgjedhor si dhe të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është llogaritur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore si më poshtë:

Numri total i shtetasve 4627824 është pjesëtuar me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, ku është përcaktuar numri 33056 si numri mesatar i shtetasve që i takojnë çdo mandati [numri real i dalë nga pjesëtimi është 33055,88571]. Numri i shtetasve për çdo zonë zgjedhore është pjesëtuar me numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati. Çdo zone zgjedhore i është caktuar një numër mandatesh i barabartë me numrin e plotë të përfutur nga ky pjesëtim.

Pas këtij veprimi mbetën pa u shpërndarë edhe 7 mandate për të plotësuar numrin 140.

Në bazë të nenit 75, pika 5, të Kodit Zgjedhor këto mandate u janë shpërndarë zonave zgjedhore (qarqeve) që kanë mbetjen më të madhe pas presjes zgjedhore, të numrit të përfutur nga pjesëtimi i mësipërm. Veprimet e kryera janë të pasqyruara si më poshtë vijon:

Nr.	Qarku/ zona zgjedhore	Shtetas 2024	Shtetas/ nr mesatar	Mandate nga e plota	Mbetja		Mandate nga mbetja	Mandate gjithsej
					nr	shtetas		
1	Berat	226.475	6,851	6	0,851	28.140	1	7
2	Dibër	170.488	5,158	5	0,158	5.209		5
3	Durrës	478.345	14,471	14	0,471	15.563		14
4	Elbasan	451.879	13,670	13	0,670	22.152	1	14
5	Fier	512.288	15,498	15	0,498	16.450	1	16
6	Gjirokastrë	143.491	4,341	4	0,341	11.267		4
7	Korçë	345.893	10,464	10	0,464	15.334		10
8	Kukës	112.599	3,406	3	0,406	13.431		3
9	Lezhë	228.416	6,910	6	0,910	30.081	1	7
10	Shkodër	348.074	10,530	10	0,530	17.515	1	11
11	Tiranë	1.219.520	36,893	36	0,893	29.508	1	37
12	Vlorë	390.356	11,809	11	0,809	26.741	1	12
	Totali	4627824	140,000	133			7	140
	Nr mesatar	33056						

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

Daniela ALIMEMETI

- Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Pavlina DOÇAJ

- Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR**

Data:

Nr:

Ora: :

PROJEKTVENDIM

PËR

**CAKTIMIN E NUMRIT TË MANDATEVE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE,
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË VITIT 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 2 shkronja "b", e 3, nenit 74, pika 1, neni 75 dhe neni 76, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Iirjana NANO-

Kryetar

Arens ÇELA-

Anëtar

Dritan ÇAKA-

Anëtar

Helga VUKAJ-

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ-

Anëtar

Data: dd mm vvvv Nr. 123-456
Ora: hh:mm



"Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore
për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025"

Lidhja 1

Shpërndarja e mandateve në qarqe sipas formulës dhënë në nenin 75 të Kodit Zgjedhor
(popullsia e datës 1 dhjetor 2024)

Nr.	Qarku/ zona zgjedhore	Shtetas 2020	Shtetas/ nr mesatar	Mandate nga e plotë	Mbetja		Mandate nga mbetja	Mandate gjithsej
					nr	shtetas		
1	Berat	226.475	6,851	6	0,851	28.140	1	7
2	Diber	170.488	5,158	5	0,158	5.209		5
3	Durrës	478.345	14,471	14	0,471	15.563		14
4	Elbasan	451.879	13,670	13	0,670	22.152	1	14
5	Fier	512.288	15,498	15	0,498	16.450	1	16
6	Gjirokastër	143.491	4,341	4	0,341	11.267		4
7	Korçë	345.893	10,464	10	0,464	15.334		10
8	Kukës	112.599	3,406	3	0,406	13.431		3
9	Lezhë	228.416	6,910	6	0,910	30.081	1	7
10	Shkoder	348.074	10,530	10	0,530	17.515	1	11
11	Tiranë	1.219.520	36,893	36	0,893	29.508	1	37
12	Vlorë	390.356	11,809	11	0,809	26.741	1	12
	Totali	4627824	140,000	133			7	140
	Nr mesatar	33056						



RELACION
PËR
PROJEKVENDIMIN
PËR
CAKTIMIN E KUFIJVE DHE NGRITJEN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË VITIT 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Në nenin 20, pika 2, shkronja “a” parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet për kufijtë e zonave të administrimit zgjedhor në përputhje me këtë ligj.

Neni 27 i Kodit Zgjedhor përcakton se Zonat e Administrimit Zgjedhor miratohen nga KQZ-ja, jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Gjithashtu, përcakton kriteret ligjore për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Juridiksioni territorial i ZAZ-ve, si rregull është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë.

Jo më vonë se 10 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon të dhënat KQZ-së, të ndara sipas njësive të qeverisjes vendore. Këto të dhëna janë kërkuar nga KQZ me shkresën nr. 3266 prot, datë 18.11.2024 dhe kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike në datën 3.12.2024 dhe reflektojnë shtetasit me të drejtë vote në datë 15 Maj 2025.

Neni 28, pika 1, i Kodit Zgjedhor parashikon se vendimi për ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor merret nga KQZ-ja jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektvendimi “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

Neni 27 i Kodit Zgjedhor përcakton kriteret ligjore për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Juridiksioni territorial i ZAZ-ve, si rregull është i njëjtë me territorin administrativ të bashkisë.

Bashkitë që kanë më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote ndahen nga KQZ-ja në më shumë se sa një ZAZ, duke respektuar kriterin e pandashmërisë së territorit të njësisë administrative, vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit, barrierat gjeografike, mundësitë e mira të komunikimit brenda territorit dhe numër të përafërt zgjedhësish.

Zonat e Administrimit Zgjedhor ngrihen dhe funksionojnë për çdo lloj zgjedhje dhe referendumi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndryshon kufijtë e ZAZ-së, nëse ka ndryshim të kriterëve të pikës 2 dhe 3, të nenit 27, të Kodit Zgjedhor.

Nga informacioni i ardhur për numrin e shtetasve me të drejtë vote, me datë reference 15 maj 2025, dhe kriterëve për ngritjen e ZAZ-ve, nga 61 bashki rezulton se:

Nga verifikimi i të dhënave në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për numrin e shtetasve me të drejtë vote në datën 15 maj 2025, dhe kriterëve për ngritjen e ZAZ-ve të përcaktuara në nenin 27, pika 2 të Kodit Zgjedhor, nga 61 bashki rezulton se:

- 50 bashki kanë më pak se 80 mijë zgjedhës, ashtu siç kanë qenë dhe zgjedhjet e kaluara e nuk lind nevoja për ndryshimin e tyre.
- 11 bashki (Shkodër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Kamëz, Elbasan, Berat, Lushnjë, Fier, Korçë dhe Vlorë) aq sa kanë qenë dhe zgjedhjet e kaluara, kanë më shumë se 80 mijë zgjedhës dhe janë të ndara në më shumë se një ZAZ.
- Në 11 bashkitë ka dy ZAZ, ajo me numër 21 në Bashkinë e Durrësit dhe ajo me numër 29 në Bashkinë e Tiranës, të dyja në zonën rurale, që kanë më shumë se 80 mijë zgjedhës, përkatësisht 83.168 dhe 82.631, dhe propozohet të ndahen si më poshtë:
 - a) Për të ruajtur vazhdimësinë dhe kompaktësinë e territorit dhe numërin e përafërt të zgjedhësve propozohet të ndahet ZAZ me numër 21 e Bashkisë Durrës, në dy zona të përcaktuara në lidhjen nr.1 që i bashkëlidhet këtij akti. Konkretisht në Bashkinë Durrës njësitë administrative Ishëm, Sukth dhe Manëz do të përfshihen në një ZAZ dhe njësitë administrative Rashull dhe Katund i ri në një tjetër ZAZ.

- b) Në Bashkinë Tiranë propozohet tw mos ndahet ZAZ nr.29 por të zhvendoset nga kjo ZAZ njësia administrative Petrelë me 5460 zgjedhës dhe të kalojë në ZAZ-në vijuese atë me nr.30 e cila ka 69026 zgjedhës. Në këtë mënyrë ruhet si kriteri i vazhdimësisë dhe kompaktësisë së territorit, numëri i përafërt i zgjedhësve dhe shmanget shtimi i një ZAZ-je.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025”.

Daniela ALIMEMETI

- Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Pavlina DOÇAJ

- Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**CAKTIMIN E KUFIJVE DHE NGRITJEN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË VITIT 2025**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "a", pika 2 shkronja "a" dhe pika 3, nenit 27 dhe nenit 28 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Caktimin e kufijve dhe ngritjen e 93 (nëntëdhjetë e tre) Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Iirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



"Për caktimin e kufijve dhe ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025"

ZONAT E ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR SIPAS NUMRIT TË ZGJEDHËSVE - 2025

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr										
1	Shkodër	1	MALËSI E MADHE	1	Gruçmirë	12.222	46.240	01										
				2	Kastrat	10.580												
				3	Kelmend	5.222												
				4	Koplik	7.306												
				5	Qendër-Malesi e Madhe	6.069												
				6	Shkrel	4.841												
		2	SHKODËR	16	SHKODËR	7	Ana Malit	4.911	75.631	02								
						8	Berdicë	7.996										
						9	Dajç	7.496										
						10	Gur i zi	9.445										
						11	Postribë	9.219										
						12	Pult	2.193										
						13	Rrethinat	22.656										
						14	Shalë, Shosh	3.710										
						15	Velipojë	8.005										
						Shkodër (zona QV 0235 deri 0245, zona QV 0269, zona QV 0279, zona QV 0280, zona QV 0282, zona QV 0284, zona QV 0286 deri 0297 dhe zona QV 0299 deri 0304)					97.565		03					
						Shkodër (zona QV 0246 deri 0263, zona QV 0265 deri 0268, zona QV 0270, zona QV 0276, zona QV 0316, zona QV 0318, zona QV 0319 dhe zona QV 0321)										04		
						Shkodër (zona QV 0271 deri 0275, zona QV 0277, zona QV 278, zona QV 281, zona QV 0283, zona QV 0285, zona QV 0298, zona QV 0305 deri 0315, zona QV 0317, zona QV 0320, zona QV 0322 dhe zona QV 0323)												
						3	VAU-DEJËS					17	Bushat	20.167	40.901	06		
												18	Hajmet, Vig Mnele	7.043				
19	Shllak											1.460						
20	Vau Dejes, Temal	12.231																
4	PUKË			21	Gjegjan	2.743	11.657	07										
				22	Pukë, Rrapë	6.895												
				23	Qerret, Qelëz	2.019												
5	FUSHË-ARRËZ			24	Fierzë	1.364	8.613	08										
				25	Fushë Arrëz, Qafë Mali, Blërim	6.053												
				26	Iballë	1.196												
2	Kukës	6	TROPOJ	27	B. Curri	6.769	22.704	09										
				28	Bujan	2.281												
				29	Bytyc	1.659												
				30	Fierzë	1.869												
				31	Lekbibaj	1.241												
				32	Llugaj	1.762												
				33	Margegaj	2.597												
				34	Tropojë	4.526												
		7	HAS			35	Fajzë	3.338	17.116	10								
						36	Golaj	6.312										
						37	Krumë, Gjinaj	7.466										
		8	KUKËS			38	Bicaj, Ujmisht	6.309	46.745	11								
						39	Bushtricë, Grykë Çaje, Kalis	2.850										
						40	Kukës, Kolsh	20.720										
41	Malzi					2.577												
42	Shishtavec					3.859												
43	Shiqen					2.873												

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr
3	Lezhë			44	Surroj, Arren	1.536		
				45	Tërthore	2.660		
				46	Topojan	1.539		
				47	Zapod	1.822		
		9	LEZHË	48	Lezhë	26.723	46.761	12
				49	Ballëdren	8.713		
				50	Shëngjin	11.325		
				51	Blinisht	4.655	46.182	13
				52	Dajç	6.052		
				53	Kallmet	5.914		
				54	Kolsh	6.281		
				55	Shënkoll	13.869		
		10	MIRDITË	56	Ungrej	1.995		
				57	Zejmen	7.416		
				58	Fan	3.093		
				59	Kthellë, Selitë	3.640		
60	Orosh			2.321				
11	KURBIN	61	Rrëshen, Kaçinar	12.559	27.954	14		
		62	Rubik	6.341				
		63	Fushë Kuqe	7.441				
		64	Laç	23.923				
		65	Mamurras	18.770				
		66	Milot	9.672				
4	Dibër	12	MAT	67	Baz	2.321	29.367	16
				68	Burrel	13.570		
				69	Derjan, Macukull	2.164		
				70	Komsi	3.873		
				71	Lis	3.589		
				72	Rukaj	2.468		
				73	Ulëz	1.382		
		13	KLOS	74	Gurre	2.963	15.645	17
				75	Klos	7.911		
				76	Suç	2.594		
				77	Xibër	2.177		
		14	BULQIZË	78	Bulqizë	9.245	30.039	18
				79	Fushë Bulqizë	3.078		
				80	Gjoricë	4.156		
				81	Martanesh	1.589		
				82	Ostren, Klenjë	3.125		
				83	Shupenzë	5.192		
				84	Zerqan	3.654		
		15	DIBËR	85	Arras	2.499	57.687	19
86	Fushë Cidhen			2.611				
87	Fushë Muhur			2.391				
88	Kala e Dodës			1.562				
89	Kastriot			5.673				
90	Lurë			827				
91	Luzni			2.089				
92	Maqellare			10.847				
93	Melan			3.292				
94	Peshkopi			14.879				
95	Selishtë			1.094				
96	Silove			2.063				
16	KRUIË	97	Tomin	6.468	66.237	20		
		98	Zall Dardhë, Zall Rec	1.392				
		99	Bubq	7141				
				100	Cudhi	2192		
				101	Fushë Kruje	21811		

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr
5	Durrës	16		102	Kodër Thumanë	13349		
				103	Kruje	12961		
				104	Nikel	8783		
		17	DURRËS	105	Ishem	7.335	40.886	21
				106	Sukth	23.807		
				107	Manëz	9.744		
				108	Rashbull	29.113	42.282	22
				109	Katund i ri	13.169		
				110		Durrës (zona QV 1408 deri 1424, zona QV 1458, zona QV 1459, zona QV 1463, zona QV 1467 deri 1470)		190.391
		Durrës (zona QV 1429, zona QV1433, zona QV 1443, zona QV 1444, zona QV 1446 deri 1451, zona QV 1461, zona QV1462, zona 1471 deri 1482, zona QV 1484 deri 1494, zona QV 1501, zona 1503 dhe zona QV 1504)				24		
		Durrës (zona QV 1425 deri 1428, zona QV1430 deri 1432, zona QV 1434 deri 1442, zona QV 1452 deri 1457, zona QV 1460, zona QV 1464. zona QV 1465, zona QV 1483 dhe zona QV 1495 deri 1500)				25		
		18	SHIJAK	111	Gjepalaj	4.578	38.114	26
				112	Maminas	6.281		
				113	Shijak	11.304		
114	Xhafzotaj			15.951				
6	Tiranë	19	VORË	115	Bërxiull	9.152	31.642	27
				116	Prezë	5.614		
				117	Vorë	16.876		
		20	KAMËZ	118	Kamëz	74.205	74205	28
				119	Paskuqan	39.104	39104	29
		21	TIRANË	120	Kashar	52220	77.171	30
				121	Ndroq	7.311		
				122	Vaqarr	8.241		
				123	Pezë	5.140		
				124	Baldushk	4.259		
				125	Bërzhitë	4.807	69.026	31
				126	Dajt	24.144		
				127	Farkë	22.091		
128	Petrelë			5.460				
129	Krrabë			2.466				
130	Shëngjergj	1.967	3.879					
131	Zall-Bastar	3.879						
132	Zall-Herr	9.672						
133	Njësia Administrative Tiranë1	42.614	42.614	32				
134	Njësia Administrative Tiranë2	70.541	70.541	33				
135	Njësia Administrative Tiranë3	39.017	39.017	34				
136	Njësia Administrative Tiranë4	54.665	54.665	35				
137	Njësia Administrative Tiranë5	73.918	73.918	36				
138	Njësia Administrative Tiranë6	56.178	56.178	37				
139	Njësia Administrative Tiranë7	65.462	65.462	38				
140	Njësia Administrative Tiranë8	34.834	34.834	39				
141	Njësia Administrative Tiranë9	54.979	54.979	40				
142	Njësia Administrative Tiranë10	23.755	23.755	41				
143	Njësia Administrative Tiranë11	52.651	52.651	42				

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr
7	Tira	22	KAVAJË	144	Golem	11.412	68.287	43
				145	Helmes	4.215		
				146	Kavajë	34.371		
				147	Luz i vogël	8.855		
				148	Syncj	9.434		
		23	RROGOZHINË	149	Gose	7.107	33.611	44
				150	Kryevidh	7.519		
				151	Lekaj	7.726		
				152	Rrogozhinë,Sinaballaj	11.259		
		Elbasan	24	PEQIN	153	Gjocaj	6.063	31.271
154	Pajove				7.373			
155	Peqin,Karine				8.853			
156	Përparim				4.395			
157	Shezë				4.587			
25	BELSH		158	Belsh,Rrase	14.171	26.803	46	
			159	Fierze	3.164			
			160	Grekan	4.077			
			161	Kajan	5.391			
26	CËRRIK		162	Cërrik	12.197	38.652	47	
			163	Gostime	10.644			
			164	Klos	3.664			
			165	Mollas	6.311			
			166	Shalës	5.836			
27	ELBASAN		167	Bradashesh,Gracen	12.685	65.212	48	
			168	Funarë	2.135			
			169	Gjergjan	6.622			
		170	Gjinar,Zavalin	4.894				
		171	Labinot fushë	5.555				
		172	Labinot mal	4.208				
		173	Paper	7.548				
		174	Shirgjan	8.776				
		175	Shushice	9.204				
		176	Tregan	3.585				
177	Elbasan (zona QV 2300 deri 2323, zona QV 2327, zona QV 2328)		109.409	109.409	49			
	Elbasan (zona QV 2356 deri 2378)				50			
	Elbasan (zona QV 2329 deri 2355)				51			
28	GRAMSH	178	Gramsh,Skënderbegas,Kushove	13.135	27.340	52		
		179	Kodovjat,Lenie	3.119				
		180	Kukur	2.036				
		181	Pishaj,Sult,Porocan	7.489				
		182	Tunje	1.561				
29	LIBRAZHD	183	Hotohisht	5.370	33.872	53		
		184	Librazhd,Steblevë	9.812				
		185	Lunik	2.582				
		186	Orenje	3.435				
		187	Polis	4.051				
		188	Qendër LIBRAZHD	8.622				
30	PRRENJAS	189	Prrenjas	7.087	26.011	54		
		190	Qukës	8.154				
		191	Rajce	8.619				
		192	Stravaj	2.151				
		193	Allkaj	5.196				
		194	Ballagat	3.120				
		195	Bubullimë	5.913				
		196	Dushk	9.809				

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr
8	Fier	31	LUSHNJË	197	Fier Shegan	7.945	60.857	55
				198	Golem	6.297		
				199	Hysgjokaj	2.871		
				200	Karbunarë	4.506		
				201	Kolonjë	6.778		
				202	Krutje	8.422		
				203	Lushnjë	46.649		
		32	DIVJAKË	204	Divjakë	11.994	44.521	57
				205	Grabian	5.041		
				206	Gradisht	8.860		
				207	Remas	5.363		
				208	Tërbuf	13.263		
		33	FIER	209	Cakran	13.169	46.106	58
				210	Frakull	8.665		
				211	Levan	14.547		
				212	Portëz	9.725		
				213	Dermenas	10.575	45.020	59
				214	Libofshë	8.651		
				215	Mbrostar	8.745		
				216	Qendër_FIER	10.286		
				217	Topojë	6.763		
				218	Fier	79.764	79.764	60
		34	PATOS	219	Patos	25.127	34.708	61
				220	Ruzhdie	2.521		
221	Zharrëz			7.060				
35	ROSKOVEC	222	Kuman	6.875	26.342	62		
		223	Kurjan	4.163				
		224	Roskovec	7.547				
		225	Strum	7.757				
36	MALLAKASTËR	226	Aranitas,Ngracan	3.061	31.445	63		
		227	Ballsh	9.303				
		228	Fratar,Selitë	4.898				
		229	Greshicë	1.475				
		230	Hekal	3.656				
		231	Kute	2.410				
232	Qender_MALLAKASTER	6.642						
9	Berat	37	DIMAL	233	Cukalat	3.314	32.208	64
				234	Kutalli	10.824		
				235	Poshnje	8.464		
				236	Ura Vajgurore	9.606		
		38	KUCOVË	237	Kozare	6.785	45.947	65
				238	Kuçovë	24.388		
				239	Lumas	5.517		
				240	Perondi	9.257		
		39	BERAT	241	Berat	53.253	53.253	66
				242	Otlak	12.494	29.003	67
				243	Roshnik	2.869		
				244	Sinje	4.050		
				245	Velabisht	9.590		
		40	POLICAN	246	Poliçan	5.999	12.947	68
				247	Terpan	1.572		
				248	Vertop	5.376		
				249	Bogovë,Vendresh	2.118		

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr
		41	SKRAPAR	250	Cepan	696	13.169	69
				251	Çorovodë	4.591		
				252	Gjërbes,Zhepë	1.462		
				253	Potom	762		
				254	Qendër SKRAPAR,Leshnjë	3.540		
10	KORÇË	42	POGRADEC	255	Bucimas	16.126	74.784	70
				256	Cerravë	7.604		
				257	Dardhas	2.689		
				258	Pogradec	33.221		
				259	Proptisht	4.488		
				260	Trebinje	2.265		
				261	Udenisht	6.147		
				262	Velcan	2.244		
		43	MALIQ	263	Gore	2.663	50.237	71
				264	Libonik	11.093		
				265	Maliq	6.463		
				266	Pirg	7.948		
				267	Pojan	13.688		
				268	Vreshtas	8.382		
		44	PUSTEC	269	Pustec	4.432	4.432	72
		45	DEVOLL	270	Bilisht	8.754	34.081	73
				271	Hoçisht	5.541		
				272	Miras	7.908		
				273	Progër	4.816		
		46	KORÇË	274	Qendër Bilisht	7.062	34.536	74
				275	Drenovë	8.769		
				276	Mollaj,Vithkuq	7.036		
				277	Qendër KORÇË	11.554		
				278	Voskop	4.681		
				279	Voskopojë,Moglicë,Lekas	2.496		
		280	Korçë	76.195	76.195	75		
47	KOLONJË	281	Ersekë,Barmash	6.001	15.190	76		
		282	Leskovik,Leskovik	2.549				
		283	Mollas,Clirim	3.054				
		284	Qendër Ersekë,Novoselë	3.586				
11	Gjirokastrë	48	PËRMET	285	Çarçove	2.344	16.305	77
				286	Përmet	8.475		
				287	Petran	2.511		
				288	Qendër PERMET,Frashër	2.975		
		49	KËLCYRË	289	Ballaban	1.485	9.407	78
				290	Dishnicë	1.840		
				291	Këlcyre	4.119		
				292	Suke	1.963		
		50	MEMALIAJ	293	F. Memaliaj	2.129	15.685	79
				294	Krahës,Qesarat	4.812		
				295	Luftinjë,Buz	3.437		
				296	Memaliaj	5.307		
51	TEPELENË	297	Qendër-Tepelenë, Kurvelesh, Lops	6.261	12.732	80		
		298	Tepelenë	6.471				
52	GJIROKASTËR	299	Cepo,Picar	5.036	43.677	81		
		300	Gjirokastrë	28.487				
		301	Lazarat	2.755				
		302	Lunxheri,Odric,Antigon	7.399				
53	LIBOHOVË	303	Libohovë,Qendër- Gjirokastrer, Zagori	5.950	5.950	82		

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Nr.	Njësia administrative	Zgjedhës njësi	Zgjedhës ZAZ	ZAZ Nr
		54	DROPULL	304	Dropull i poshtëm	8.359	20.477	83
				305	Dropull i sipërm	9.340		
				306	Pogon	2.778		
		55	VLORE	307	Novoselë	14.106	47.137	84
				308	Orikum	9.764		
				309	Qendër VLORE	15.468		
				310	Shushicë	7.799		
				311	Vlorë (zona QV 4429 deri 4434, zona QV 4436, zona QV 1437, zona QV 4443, zona QV 4456-4459, zona QV 4494, zona 4495, zona QV 4499 deri 4506 dhe zona QV 4510)	124.321		85
					Vlorë (zona QV 4427, zona QV 4428, zona QV 4438 deri 4442, zona QV 4444 deri 4455, zona QV 4482 deri 4487, zona QV 4507 deri 4509)			86
					Vlorë (zona QV 4460 deri 4481, zona QV 4488 deri 4493, zona QV 4496 deri 4498)			87
		56	SELENICË	312	Armen	5.336	27.374	88
				313	Brataj	3.691		
				314	Kotë	5.141		
				315	Selenicë	5.577		
				316	Sevaster	2.250		
				317	Vllahinë	5.379		
		57	HIMARË	318	Himarë	12.576	23.379	89
				319	Hore Vranisht	2.778		
				320	Lukovë	8.025		
		58	DELVINË	321	Delvinë	12.036	14.976	90
				322	Vergo	2.940		
		59	SARANDË	323	Ksamil	7.582	49.085	91
				324	Sarandë	41.503		
		60	FINIQ	325	Aliko	5.197	31.650	92
				326	Dhivër	5.690		
				327	Finiq	5.599		
				328	Livadhja	9.310		
				329	Mesopotam	5.854		
		61	KONISPOL	330	Konispol	2.490	11.555	93
				331	Markat	2.453		
				332	Xarrë	6.612		
					Gjithsej	3.729.317	3.729.317	93

12

Vlorë